



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË**
AKT-MIRATIMI**ORGAN I MIRATUAR****I VLERËSIMIT TË KONFORMITETIT.**

Mbështetur në Kreun V të ligjit Nr. 10489, datë 15.12.2011 “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore” i ndryshuar, Urdhrin e Ministrit Nr. 53 datë 05.10.2017 Për miratimin e rregullores “Për procedurat e miratimit dhe mbikëqyrjes së organeve evropiane të notifikuara dhe organeve të miratuara të vlerësimit të konformitetit” edhe në Çertifikaten e Akreditimit me Nr. Regjistrimi **TI 042**,

MIRATOJ:

Subjekti:	“ALCERT” shpk.
Me Administrator:	Anila JANI
Me Drejtues Teknik:	Ervin Minga (pnp; mekanik). Llazar Shandro (elektrik).
Adresa e subjektit:	Rruga “Abdyl Frashëri”, Ndërtesa Nr. 9, H. 3, Ap. 18 Tiranë.
Cel.:	069 750 1178
E-mail:	alcertadm@gmail.com anila.jani@alcert.al

të ushtrojë veprimtarinë si Organ i Miratuar i Vlerësimit të Konformitetit (OMVK):

Tipi i OMVK-së:	Tipi A
Fusha e Veprimtarisë:	<u>I. Fusha e inspektimit PNP:</u> - Rezervuarë të GLN-së nën edhe të barabartë me 13 m³ - Rezervuarë të GLN-së mbi 13 m³; - Tubacionet nën presion. Aksesorët e sigurisë edhe aksesorët nën presion; - Kaldaja me avull edhe ujë të nxehtë; - Enë nën presion kriogjenike; - Pajisjeve nën presion stacionare, përjashtohen GLN dhe ato kriogjenike; - Rezervuarë të hidrokarbureve të lëngët.

II. Vlerësimin e konformitetit të Projekteve Teknike dhe Teknologjike për Produktet/Pajisjet/Instalimet teknologjike nën Presion;

III. Lëshimin e Vërtetimeve Teknike për subjektet që kryejnë aktivitete në fushën e përpunimit, transportimit dhe tregtimit të naftës dhe nënprodukteve të saj.

IV. Fusha e inspektimit Mekanik:

Pajisje ngritëse:

- a) Vinça tip Kullë
- b) Vinça Urë
- c) Vinça të lëvizshëm
- d) Ura për servisimin e mjeteve
- e) Platformat Ngritëse
- f) Platforma të lëvizshme për ngritjen e njerëzve në lartësi.
- g) Pirunë ngritës.
- h) Pajisje manuale ngritëse.

V. Fusha e inspektimit Elektrik:

- a) Impiante të mbrojtjes ndaj shkarkimeve atmosferike;
- b) Impiante tokëzimi;
- c) Kabina elektrike TM/TU;
- d) Linja elektrike ajrore me tension mbi 1 kV;
- e) Linja elektrike kabllore me tension mbi 1 kV;
- f) Impiante shpërndarës-Nenstacionet;
- g) Instalime elektrike në ambiente civile;
- h) Instalime elektrike industriale.

Rregullat teknike/
standardet e sigurisë së
produktit/pajisjes/instali
mit të vënë në shërbim:

1. VKM Nr. 1062, datë 23.12.2015, “Për pajisjet dhe bashkësitë nën presion dhe përcaktimin e standardeve të harmonizuara” (aneksi V);
2. Standardi SSH EN 12817 - “Pajisje dhe aksesoret për GLN - Inspektimi dhe rikualifikimi i rezervuarëve të gazit të lëngshëm të naftës (GLN) më të vegjël ose të barabartë me 13 m³”;
3. Standardi S SH EN 13175 - “Specifikimi dhe provat për ventilët dhe pajisjet e rezervuarëve të Gazit të Lëngëzuar të Naftës (GLN);
4. Standardi S SH EN 12819 - “Pajisje dhe aksesoret për GLN. Inspektimi dhe rikualifikimi i rezervuarëve të gazit të lëngshëm të naftës (GLN) me kapacitet më të madh se 13m³”;
5. Metodë jo-standarde: Rregullore e sigurimit teknik për kaldajat e avullit dhe ujit të nxehtë, nëntor 1988;
6. Metodë jo-standarde “Projektimi, prodhimi, shfrytëzimi dhe riparimi i pajisjeve nën presion.” Tiranë 1984;

7. SH EN 21009-2 "Enët nën presion kriogjenike. Enët statike të termoizoluara me vakum";
8. SH EN 14015 - "Specifikim për projektimin dhe prodhimin e rezervuarëve prej çeliku të salduar vertikale, cilindrikë, me fund të sheshtë, mbi tokë, të ndërtuar në vend për depozitim të lëngjeve në temperaturën e ambientit të lartë";
9. ISO 9927-1: Vinça- Inspektimi- Përgjithshme
10. ISO 12480-1 Vinça- Përdorimi i sigurt- Pjesa 1-Përgjithshme;
11. ISO 12482-1 Vinça- kërkesat e monitorimit- Pjesa 1- Përgjithshme;
12. ISO 4309: vinç - kavo çeliku - Kujdesi dhe mirëmbajtja, inspektimi dhe nxjerrja;
13. EN 12644 -1 + A: Vinçat - Informacioni për përdorimin dhe testimin - Pjesa 1: Udhëzimi;
14. EN 12644 -2 + A1: Vinçat -Informacioni për përdorimin dhe testimin - Pjesa 2: etiketimi.
15. EN 12999 + A1: Vinçat - Vinçat për ngarkim;
16. EN 13001-1: Vinçat - Projekti i përgjithshëm - Pjesa 1: Parimet e përgjithshme dhe kërkesat;
17. EN 13135: Vinçat - Siguria - Projektimi - Kërkesat për pajisjet;
18. EN 14439 + A2: Vinçat - Siguria - Vinçat me Kulle;
19. EN 14492-1 + A1 + AC: Vinçat – Pajisjet e fuqisë (tamburot cikriket) me veprim të mekanizuar - Pjesa 1;
20. EN 14492-2 + A1 + AC: Vinçat - Pajisjet e fuqisë (tamburet cikrikët) me veprim të mekanizuar - Pjesa 1;
21. EN 14502-1: Vinçat - Pajisjet për ngritjen e personave - Pjesa 1: Kovat që janë të varur;
22. EN 14502-2 + A1: Vinçat - Pajisjet për ngritjen e personave - Pjesa 2: ngritja me stacion kontrolli;
23. EN 14985: Vinçat - Vinçat me krahë të kthyeshem;
24. EN 15011 + A1: Vinçat - vinça urë dhe portale;
25. 13157 + A1: Vinçat - Siguria - Vinçat me veprim manual;
26. EN 14238 + A1: Vinçat - Pajisjet me veprim manual për lëvizjen e mallrave;
27. EN 280 + A1: Platforma e punës së lëvizshme - Llogaritjet projektuese - Kriteret e stabilitetit - ndërtimi - Siguria - Ekzaminimi dhe testimi;
28. EN 1398: Pjerrësia e nivelimit - Siguria;
29. EN 1493: Vinçat për servisimin e automjeteve;
30. EN 1494 + A1: Pajisjet e lëvizshme dhe pajisjet e tyre për ngritje;
31. ISO 22915-2: "Industrial trucks. Verification of stability Counterbalanced trucks with mast";
32. ISO 2330: "Fork-lift trucks - Fork arms - Technical characteristics and testing";
33. ISO 5057: "Industrial trucks - Inspection and repair of fork arms in service on fork-lift trucks";
34. Ligji Nr. 8734, datë 1.2.2001 "Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe instalimeve elektrike", i ndryshuar;

35. Vendim Nr. 482, Datë 17.6.2020 Për miratimin e rregullës teknike, “Për kushtet teknike dhe garantimin e sigurisë së linjave elektrike me tension të lartë, mbi 1 kV”;
36. VKM Nr. 483, date 17.6.2020. Për miratimin e rregullës teknike, “Për kushtet teknike dhe garantimin e sigurisë së instalimeve elektrike te tensionit te larte, mbi 1 kV”;
37. Rregullore e sigurimit dhe e shfrytëzimit teknik për impiantet, instalimet dhe pajisjet elektrike, Tirane 2003;
38. IEC 62305-1:2010, Mbrojtja kundër rrufesë - Pjesa 1: Parime të përgjithshme;
39. IEC 62305-2:2010, Mbrojtja kundër rrufesë - Pjesa 2: Menaxhimi i rrezikut;
40. IEC 62305-3:2010, Mbrojtja kundër rrufesë - Pjesa 3: Dëmtimi fizik i strukturave dhe rreziku i jetës;
41. BS 7671 - 2018 - Requirements for Electrical Installations;
42. Rregullore e sigurimit dhe e shfrytëzimit teknik për impiantet, instalimet dhe pajisjet elektrike, Tirane 2003;
43. VKM Nr. 1054, Datë 23.12.2015 Për Miratimin e Rregullit Teknik “Për përputhshmërinë elektromagnetike” dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara.
44. S SH EN 62110: “Nivele të fushës elektrike dhe magnetike të gjeneruara nga sisteme fuqie me rrymë alternative - Procedura matje të lidhura me rezatimin e publikut”;
45. VKM Nr. 245, date 30.03.2016 Për miratimin e rregullit teknik “për kërkesat teknike në instalimin dhe kontrollin e dispozitivit diferencial, vendosur në pajisjet, impiantet dhe instalimet elektrike” dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara;
46. BS 7671: - Requirements for Electrical Installations;
47. KTP 15-78, Instalimet elektrike ne ambjente me rrezik zjarri;
48. VKM 1066/2015 Për miratimin e rregullit Teknik te pajisjeve dhe sistemeve mbrojtëse për përdorim ne ambiente potencialisht shpërthyes dhe përcaktimi i listës se standardeve të harmonizuar;
49. BS 7671: Requirements for Electrical Installations;
50. KTP 15-78, Instalimet elektrike në ambiente me rrezik zjarri.

Periudha e vlefshmërisë:

Deri më 27.06.2028

Territori i ushtrimit të veprimtarisë:

Në gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Personi përgjegjës firmosës:

Anila Jani, Administrator, Menaxher. Cilësie
Ervin Minga, Menaxher teknik

069 750 1178
alcertadm@gmail.com
anila.jani@alcert.al

OMVK regjistrohët me Nr. Identifikimi:

OMI 024 Rishikim 4

OMVK detyrohet të plotësojë gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij, kërkesat dhe kushtet sa më poshtë:

Është përgjegjës për veprimtaritë e vlerësimit të konformitetit, të kryera sipas objektit të tij të miratimit dhe çdo veprimtari tjetër të kryer, përfshirë veprimtaritë nënkontraktuese.

Nuk duhet të përfshihet në veprimtaritë që mund të krijojnë konflikt me pavarësinë/paanësinë e tij të gjykitimit ose integritetin për aktivitetet e vlerësimit të konformitetit, për të cilat ai është miratuar;

Siguron se veprimtaritë e degëve ose nënkontraktorëve të tij nuk prekin/ndikojnë në konfidencialitetin, objektivitetin, paanësinë e veprimtarive të tij të vlerësimit të konformitetit;

I siguron Ministrit (Strukturës Administrative Përgjegjëse me kërkesë zyrtare) brenda 10 ditësh, kopje të çertifikatave, raporteve të testeve dhe të vlerësimit të konformitetit, përfshirë dokumentet për to si dhe informacionin për lëshimin, refuzimin ose tërheqjen e çertifikatave për çdo subjekt;

Detyrohet të informojë Ministrin pa vonesë për çdo rast, në të cilin ky organ bëhet i paaftë të sigurojë përmbushjen e kushteve të vendosura për ushtrimin e miratimit të vlefshmërisë së konformitetit;

Informon brenda 5 ditësh Ministrin (SAP) për çdo refuzim, kufizim, pezullim ose tërheqje çertifikate;

Informon Ministrin për çdo kërkesë për informacion, të cilën ai ka marrë nga Inspektorati Shtetëror në vartësi të MIE-s për veprimtarinë e vlerësimit të konformitetit;

Detyrohet të mbajë regjistra të plotësuar rregullisht të të gjitha procedurave të vlerësimit të konformitetit, për të cilat ai është miratuar dhe të rezultateve të tyre për jo me pak se 10 vjet.

Me kërkesë të ministrit përgjegjës detyrohet të marrë pjesë në testime ose krahasime të tjera të përcaktuara për OMVK-të.

Në fund të çdo periudhe katërmujore, detyrohet ti dërgojë Ministrit (SAP) regjistrin e inspektimeve ose çertifikatave të lëshuara për periudhën në fjalë.

Organi i Miratuar detyrohet t'u krijojë akses të plotë punonjësve të SAP, të pajisur me urdhër të Ministrit, që të evidentojnë të gjitha të dhënat për përmbushjen e kërkesave të vlerësimit të konformitetit dhe të hyjnë në të gjitha ambjentet ku OMVK ka kryer vlerësim të konformitetit, të përcaktuar në miratimin e lëshuar.

Në rast të konstatimit të mos plotësimit të kërkesave dhe kushteve sipas pikave 2, 3, 4, 5, 6, 8, 9, 10, 11, ose në rast se organi i miratuar nuk arrin të përmbushë më, një apo disa kritere a kërkesa të përcaktuara në rregullat teknike përkatëse apo në rregullat për sigurinë e produktit/instalimit të vendosur në shërbim/në përdorim dhe kushtet e përcaktuara në aktin e miratimit, SAP i propozon Ministrit pezullimin e Aktit të Miratimit deri në afatin e dhënë për plotësimin e tyre.

Nëse Organi i Miratuar dështon në plotësimin e kushteve dhe kërkesave sa më sipër brenda afatit të caktuar, SAP përgatit dhe i paraqet për firmë Ministrit urdhërin për shfuqizimin e Aktit të Miratimit dhe heqjen e emrit të OMVK nga regjistri i organeve të miratuara.

Datë: 01 / 07 / 2024

**Zv. KRYEMINISTËR
DHE MINISTËR**

Belinda Balluku

**Me autorizim
Zv. MINISTRI**

